

OPERATORI I BLERJEVE TË PËRQËNDRUARA

PROCESVERBAL- Tipi i kontratës - Shërbime

PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS: “Shërbim printimi e publikimi”.

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (FPP):79800000-2.

VLERA E FONDIT LIMIT: 5 099 999 (pesë milion e nëntëdhjetë e nëntë mijë e nëntëqind e nëntëdhjetë e nëntë) lekë pa TVSH.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Autoriteti/enti kontraktor Operatori i Blerjeve të Përqëndruara sh.a. ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar.

KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 10

b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohet në nenin 82 dhe 83 të LLP-së Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, si dhe nenet 14/1, 14/2, 25, 26 të V.K.M-së Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar.

a. .Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 10;

Argumentimi: Ky kriter u vendos me mbështetje të nenit 76 të Ligjit nr. 162/2020“Për Prokurimin Publik“, dhe të nenit 26 të V.K.M nr. 285, date 19.05.2021 ”Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik“, i ndryshuar, në të cilën është e përcaktuar se: “*I Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla.*

b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;

Argumentimi: Ky kriter u vendos në mbështetje të nenit 83 Ligjin nr.162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, në të cilën është e parashikuar se: Pika 1 Neni 83: *Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël.* Pika 2 Neni 83: *Autoriteti ose enti kontraktor duhet të specifikojë në dokumentet e tenderit: a) vlerën e kërkuar të sigurimit të ofertës, e cila duhet të jetë 2% e vlerës së përlogaritur të kontratës; b) çdo kërkesë për natyrën dhe formën e sigurimit të ofertës, si dhe mbështetje të nenin 30 të V.K.M-së nr. 285 date 19.05.2021 “Per Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik” i ndryshuar.*

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

Referuar pikës 1 të shtojcës 9, ofertuesi duhet të deklarojë se përmbush kriteret e përgjithshme të pranimit/kualifikimit. Këto kriteret duhet të plotësohen me dorëzimin e vetëdeklaratës me shkrim të subjektit, në ditën e hapjes së ofertës, sipas Shtojcës 10.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 76 të ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar dhe nenit 25 të VKM-se Nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik" i ndryshuar.

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore të 3 (tre) viteve të fundit financiare (2023-2024-2025), ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 39 % e vlerës së fondit limit.

Kërkesa e mësipërme konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomike arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, të ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, si dhe nenit 43, pika 2, germa c, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, ku është përcaktuar qartë vlera e kërkuar për xhiron minimale vjetore, si dhe Rekomandimit të APP-së nr. 7998 date 24.12.2021 “Rekomandim hartimin e kriterëve për kualifikim për procedurat e prokurimit për mallra, punë, shërbime” . Vlera e kërkuar është brenda kufijve të vendosur në dispozitat më sipër, dhe është vendosur me qëllim që Autoritetet Kontraktore të sigurohet për potencialin ekonomiko-financiar të OE ofertues, që lidhet drejtëpërdrejtë me qëndrueshmërinë dhe vijimësinë e veprimtarisë së operatorëve ekonomikë në treg, si një element i rëndësishëm në realizimin e objektit të prokurimit dhe përmbushjes së detyrimeve kontraktore.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, nenit 43, pika 1, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar. Autoritetet Kontraktore në vendosjen e këtij kriteri ka mbajtur në vëmendje nenin 61 të Ligjit nr.29/2023 "Për tatimin mbi të ardhurat" i ndryshuar, si dhe kërkesat e Ligjit nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”.

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për shërbimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 19 % të vlerës së fondit limit.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) Për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, ose faturave tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.
- b) Për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe nenit 55, pika 4, gërma b, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 19 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në dispozitat e sipërcituara.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Vlera e kërkuar është përcaktuar bazuar në legjislacionin e fushës, konkretisht, nenit 55, pika 4, gërma b, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, duke shërbyer kështu si një garanci për Autoritetet Kontraktore, që ofertuesit zotërojnë kapacitete dhe eksperiencë për të zbatuar marrëveshjen kuadër, me sukses sipas një standarti të përshtatshëm cilësie dhe në përmbushje të specifikimeve teknike.

2.3.2 Operatorët ekonomikë duhet të deklarojnë se disponojnë pajisjet e nevojshme për zbatimin e kontratës, si vijon:

Nr.	Përshkrimi	Nj/M	Sasia
1	Pajisje Multifunksionale e madhe A3 Bardh/zi	Copë	4
2	Pajisje Multifunksionale e madhe A3 me ngjyra	Copë	1
3	Pajisje Multifunksionale e vogël MFP A4	Copë	82
4	Pajisje Multifunksionale me ngjyra MFP A4	Copë	3
5	Pajisje Printer Bardhe/zi me leter A4	Copë	10
	Shuma e pajisjeve	Copë	100

Për të vërtetuar përmbushjen e këtij kriteri, duhet të paraqitet:

- Deklarate ku të cilesohet prodhuesi i pajisjeve dhe nëse keto pajisje ofertuesi i ka në pronësi, ose me qera, ose me huapërdorje.
- katalog/skedë teknike të prodhuesit, ku të tregohen qartë karakteristikat e pajisjeve, në mënyrë që të krahasohet pajtueshmëria e tyre me specifikimet teknike dhe standartet e kërkuara.
- Operatorët Ekonomik për të dëshmuar disponimin e pajisjeve duhet të paraqesë (fatura blerje / dokumente zhdoganimit / kontrata qiraje / kontrata huapërdorje / kontratë dhurimi/ çdo dokument tjetër me anë të të cilit fitohet e drejta e pronësisë ose përdorimit sipas Kodit

Civil të Republikës së Shqipërisë) për pajisjet e deklaruar. *Germa c) konsiderohet e përmbushur me plotësimin e formularit sipas shtojcës 10 të DT. Deklarata provuese të kërkuara më sipër, do të paraqiten nga ofertuesi i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit ose nëse kërkohen sqarime nga Autoriteti Kontraktor.*

Argumentim: Ky kriter është vendosur në mbështetje të nenit 77, pika 4, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, sipas të cilit autoritetet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë disponojnë burimet e nevojshme teknike dhe profesionale, si dhe kapacitetet e duhura për realizimin e kontratës sipas standardeve të kërkuara të cilësisë. Gjithashtu, kriteri mbështetet në nenin 41, pika 4, shkronja “ç”, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, i cili parashikon se autoriteti kontraktor mund të kërkojë nga operatorët ekonomikë të provojnë se disponojnë ose mund t’u vihen në dispozicion mjetet dhe pajisjet teknike të nevojshme për realizimin e kontratës. Kërkesa për disponimin e pajisjeve objekt të këtij kriteri është e lidhur ngushtësisht me natyrën, shpërndarjen dhe kompleksitetin e kontratës, pasi realizimi i shërbimit kërkon vënien në dispozicion, instalimin dhe funksionimin e një numri të konsiderueshëm pajisjesh multifunksionale dhe printerësh, të cilat përbëjnë elementin kryesor për ekzekutimin e kontratës. Për këtë arsye, autoriteti kontraktor e vlerëson të domosdoshme që operatorët ekonomikë të provojnë aftësinë e tyre për të siguruar pajisjet e kërkuara në kohën dhe cilësinë e duhur. Kërkesa për paraqitjen e katalogëve ose skedave teknike të prodhuesit synon të verifikojë përputhshmërinë e pajisjeve të ofruara me specifikimet teknike dhe standardet e përcaktuara në dokumentet e tenderit, duke garantuar që pajisjet e propozuara plotësojnë kërkesat funksionale dhe teknike të autoritetit kontraktor. Nëpërmjet këtij kriteri, autoriteti kontraktor synon të vlerësojë kapacitetin teknik dhe organizativ të operatorëve ekonomikë për realizimin me sukses të kontratës, të minimizojë rrezikun e mosrealizimit ose vonesave në ekzekutim dhe të sigurojë përmbushjen e kërkesave teknike dhe funksionale të shërbimit objekt prokurimi. Sasia e pajisjeve të kërkuara është përcaktuar në përputhje me nevojat reale të Autoritetit Kontraktor Përfitues dhe është bazuar në analizën e kërkesave operative për pajisje printimi dhe multifunksionale në të gjitha strukturat përfituese. Numri i pajisjeve është llogaritur duke marrë në konsideratë shpërndarjen dhe nevojat funksionale të Drejtoria Vendore e Policisë Durrës, Komisariati i Policisë Kavajë, Komisariati i Policisë Shijak, Stacioni i Policisë Plazh, Stacioni i Policisë Manëz, Stacioni i Policisë Golem dhe Stacioni i Policisë Rrogozhinë. Për rrjedhojë, sasia e kërkuar është në raport të drejtë me objektin e kontratës.

2.3.3 Operatorët ekonomikë duhet të ketë personelin teknik të nevojshëm për realizimin e e shërbimit objekt prokurimi, si më poshtë:

a. 2 (dy) inxhinieri të fushës së teknologjisë së informacionit IT, informatikës, inovacionit, elektronikës apo mekanik. Për keta punonjës të paraqitet diploma e kërkuar dhe kontrata e punës e vlefshme me operatorin ekonomik ofertues.

b. 2 (dy) punonjës teknikë të cilët do të kryejnë funksionin e mirembajtjes së pajisjeve dhe do të realizojnë asistencën teknike gjatë kryerjes së shërbimit. Për keta punonjës të paraqitet kontrata e punës e vlefshme me operatorin ekonomik ofertues.

c. 2 (dy) nga punonjësit e mesiperm të përmendur në pikën a dhe b, duhet të jenë të trajnuar/certifikuar nga prodhuesit /distributorët e autorizuar të pajisjeve/ organe të akredituar kompetente ose ekuivalente (pika 2.3.2 tabela nr.1-3) për shërbim mirembajtje printerash apo pajisjesh elektronike. Në lidhje me keta punonjës të paraqitet edhe certifikimi perkates.

Ky Kriter konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit sipas shtojcës 10 të DT. Deklarata provuese të kërkuara më sipër, do të paraqiten nga ofertuesi i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit ose nëse kërkohen sqarime nga Autoriteti Kontraktor.

Argumentimi: Në mbështetje të nenit 77, pika 4, të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, si dhe nenit 41, pika 4, shkronjat b) dhe c), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar, Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të kërkojë nga operatorët ekonomikë dëshmi mbi disponimin e personelit të nevojshëm dhe të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Kërkesa për disponimin e personelit teknik përbën një element thelbësor të kapacitetit profesional të operatorëve ekonomikë ofertues dhe lidhet drejtpërdrejt me natyrën dhe kompleksitetin e objektit të prokurimit. Fushat e diplomimit të kërkuara janë përcaktuar në mënyrë gjithëpërfshirëse dhe jo kufizuese, duke përfshirë teknologjinë e informacionit, informatikën, elektronikën, inovacionin, mekanikën apo fusha të tjera të ngjashme që lidhen me realizimin e shërbimit objekt prokurimi, duke garantuar kështu pjesëmarrjen e gjerë të operatorëve ekonomikë në procedurë. Kërkesa për disponimin e dy inxhinierëve është e nevojshme për të garantuar menaxhimin teknik, instalimin, konfigurimin, monitorimin dhe mirëmbajtjen e pajisjeve gjatë gjithë periudhës së zbatimit të marrëveshjes kuadër. Duke qenë se objekti i prokurimit përfshin shërbime printimi dhe fotokopjimi, personeli me formim në fushat e sipërpërmendura disponon njohuritë dhe aftësitë e nevojshme për identifikimin dhe diagnostikimin e defekteve, mirëmbajtjen parandaluese, zëvendësimin e komponentëve elektronikë apo mekanikë dhe garantimin e funksionimit të vazhdueshëm të pajisjeve.

Po ashtu, kërkesa për dy punonjës teknikë lidhet me nevojën për sigurimin e asistencës teknike dhe ndërhyrjeve në terren gjatë zbatimit të kontratës. Këta punonjës duhet të jenë në gatishmëri për trajtimin e problematikave, defekteve, paqartësive apo çdo situatë tjetër që mund të ndikojë në vijueshmërinë e shërbimit. Disponimi i më shumë se një personi teknik mundëson reagim të shpejtë, shmang vonesat në ofrimin e shërbimit dhe garanton vazhdimësinë operacionale të tij.

Gjithashtu, kërkesa që të paktën dy nga personat e sipërpërmendur të jenë të trajnuar ose certifikuar nga prodhues/ distributorë të autorizuar /organe kompetente të akredituara ose ekuivalente për mirëmbajtjen e printerëve ose pajisjeve elektronike, është e justifikuar nga nevoja për të garantuar cilësinë e shërbimit, korrektësinë e ndërhyrjeve teknike dhe respektimin e standardeve. Certifikimet përkatëse dëshmojnë se personeli zotëron njohuri të specializuara për pajisjet objekt mirëmbajtjeje dhe është i aftë të kryejë ndërhyrje profesionale sipas praktikave dhe standardeve të njohura të industrisë.

2.3.4 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin një deklaratë me anë të së cilës të deklarojnë se marrin përsipër riparimin e pajisjeve në rast defektesh si dhe garatojë suport teknike në rast nevojë.

Argumentimi: Kjo kërkesë vendoset në bazë të nenit 41, pika 6, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i cili lejon Autoritetin/entin kontraktor, që përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kritere të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës, me qëllim që AK të krijojë siguri për që ofertuesi merr përsipër ekzekutimin e kontratës, sipas të gjitha kërkesave të përcaktuara në specifikimet teknike.

2.3.5 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin një deklaratë me anë të së cilës të deklarojnë se marrin përsipër transportin e pajisjeve të kërkuara në pikën 2.3.2 në adresën e Autoritetit Kontraktor.

Argumentimi: Kjo kërkesë vendoset në bazë të nenit 41, pika 6, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i cili lejon Autoritetin/entin kontraktor, që përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kritere të tjera të veçanta, në

varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës, me qëllim që AK të krijojë siguri për që ofertuesi merr përsipër ekzekutimin e kontratës, sipas të gjitha kërkesave të përcaktuara në specifikimet teknike.

Specifikimet Teknike:

Për te realizuar sistemin e shërbimit te printimit/fotokopjimit/skanimit kërkohen sasia e pajisjeve te mëposhtme.

Nr.	Përshkrimi	Nj/M	Sasia
1	Pajisje Multifunksionale e madhe A3 Bardh/zi	cope	4
2	Pajisje Multifunksionale e madhe A3 me ngjyra	Cope	1
3	Pajisje Multifunksionale e vogël	cope	82
4	Pajisje Multifunksionale me ngjyra	cope	3
5	Pajisje Printer Bardhe/zi me leter A4	Cope	10
	Shuma e pajisjeve	cope	100

Shënim:

a) Sasia e pajisjeve është e përafërt dhe mund të ndryshojë në varësi të nevojave të institucionit. Sasia e pajisjeve nuk mund të jetë më shumë apo më pak se 10% e totalit të kërkuar për të gjithë pajisjet.

b) Kërkohet që gjatë implementimit apo zëvendësimit të pajisjeve të mos jenë më shumë se dy marka.

Argumentimi i vendosjes se karakteristikave teknike: Kjo kërkesë teknike kërkohet për arsye :

- 1-Standartizimin e infrastrukturës se printimit në të gjithë strukturat e DVP Durrës
- 2-Lehtesimin e administrimit dhe konfigurimit në vazhdimësi nga specialistet e IT.
- 3-Garantimin e kamptibilitetit teknik dhe funksional ndërmjet pajisjeve.
- 4-Lehtesimin e përdormit dhe trajnimit të personelit.

c) Funksionimi i skanimit duhet të jetë nepërmjet kompjuterit (Skan to PC/Skan to folder).

Argumentimi i vendosjes se karakteristikave teknike: Kjo kërkesë teknike kërkohet:

- 1-Garantimin e sigurisë dhe mbrojtje te informacionit institucional.
- 2-Minimizim të riskut që lidhen me transmetimit elektronik të dokumentave.
- 3-Administrim dhe kontroll me I mire I dokumentacionit në rrjetin e brendshem të policisë.
- 4-Përputhshmëri me politikat e sigurisë IT të institucionit.
- 5-Thjeshtësim të konfigurimit dhe administrimit teknik të pajisjeve.

Pajisje Multifunksionale e madhe A3 Bardh/zi – Sasia 4 cope

Funksioni	Fotokopje / Printer / Skaner Bardh e zi
Shpejtësia “Kopje/Print per A4 B&W” jo me e vogël se:	40 ppm
Kapëse dokumentesh (stapler)	PO

Kapaciteti mbajtes se ADF/SPDF	≥50 flete
Rezolucioni i printimit jo me pak se:	600x600 dpi
Dimesione ne mm jo me i madhe se: (WxDxH)	≤620 x 700 x 1160 mm
Vendosja e dokumentit “Document Feeder”	DADF/SPDF
Formati i letrës “Media sizes”	A3/A4
Porta e komunikimit “Interface”	High Speed USB 2.0, Gigabit Ethernet 10/100/100
Printim, fotokopjim dhe skanim	Dublex automatim

Pajisje Multifunksionale e madhe A3 me ngjyra – Sasia 1 cope

Funksioni	Fotokopje/printer/skaner me ngjyra
Shpejtësia “Kopje/Print per A4 B&W” jo me e vogël se:	≥40 ppm
Kapëse dokumentesh (stapler) Automatik	PO
Dimesione ne jo me i madhe se mm: (WxDxH)	≤ 620 x 760 x 880 mm
Kapaciteti mbajtes se ADF/SPDF	≥50 flete
Rezolucioni i printimit jo me pak se:	600x600 dpi
Vendosja e dokumentit “Document Feeder”	DADF/SPDF
Formati i letrës “Media sizes”	A3/A4
Porta e komunikimit “Interface”	High Speed USB 2.0, Gigabit Ethernet 10/100/100
Printim, fotokopjim dhe skanim	Dublex automatim

- Pajisje Multifunksionale e vogël - Sasia e kërkuar - Sasia 82 cope

Funksioni	Fotokopje / Printer / Skaner
Shpejtësia “Kopje/Print per A4 B&W” jo me i vogël se:	45 ppm
Dimesioni: jo me i madh se mm: (WxDxH)	≤ 490x480x550 mm
Rezolucioni i printimit jo me i vogël se:	600x600 dpi
Vendosja e dokumentit “Document Feeder”	SPDF/DADF
Kapëse dokumentesh (stapler) automatik	PO
Formati i letrës “Media sizes”	A4
Kapaciteti mbajtes se ADF	≥50 flete

Kapaciteti standat i mbajtes së letrës jo me i vogël se:	650 fletë
Porta e komunikimit “Interface”	High Speed USB 2.0, Gigabit Ethernet 10/100/100
Printim, fotokopjim dhe skanim	Dublex automatim

- Pajisje Multifunksionale me ngjyra – Sasia 3 Cope

Fotokopje/Printer/Skaner	
“Funksioni”:	Fotokopje/printer/skaner Bardh e zi dhe me ngjyra
Shpejtësia “Kopje/Print per A4	≥ 30 ppm
Rezolucioni I Printimit	≥ 600x600
Vendosja e dokumentit “Document Feeder”:	ADF/RADF
Dimesioni: jo me i madh se mm: (WxDxH)	≤ 470 x 410x 255 mm
Kopjim/printim në të dy faqet “Duplex copying/print.”:	Po
Formati i letrës “Media sizes”:	A4
Kapaciteti në Hyrje “Input Capacity”	≥150 flete
Kapaciteti mbajtes se ADF	≥50 flete
Porta e komunikimit “Interface”	High Speed USB 2.0, Gigabit Ethernet 10/100/100

Pajisje Bardhe/zi A4 – Sasia 10 cope

Funksioni	Printer
Shpejtësia “Kopje/Print per A4 B&W” jo me i vogël se:	35 ppm
Rezolucioni i printimit jo me i vogël se:	600x600 dpi
Formati i letrës “Media sizes”	A4
Kapaciteti standat i mbajtes së letrës jo me i vogël se:	300 fletë
Porta e komunikimit “Interface”	High Speed USB 2.0, Gigabit Ethernet 10/100/100
Sistemi operativ	Instalimi do të bëhet në kompjutera me Windows 10 dhe 11

Pajisje me te cilat ne operojmë janë te sistemin Windows 10 dhe 11.

- Shpejtesia jo me e vogel se:

Argumentimi për shpejtësinë: Shpejtesit e kerkuara per pajisjet e printimit garanton qe stafi i cili do perdorin pajisjet e printimit te kete akses te shpejte ne dokumentet e printuara duke rritur produktivitetin e tyre dhe reduktuar kohen e humbur ne pritje te dokumentit.

Dimensioni W x D x H, jo me i madh se:

Eshte vendosur ky kriter per arsye te hapesires se vogel te ambjenteve të zyrave të autoritetit.

Dimesionet e pajisjeve jane percaktuar ne funksion te hapsires se disponueshme qe autoriteti ka per te instaluar pajisjet. AK ka vendosur kufijte maksimal te pajisjeve, por nuk pengon qe te propozohen pajisje me dimensione me te vogla.

Kapaciteti mbajtes i letres:

Kapaciteti mbajtes i letres per secilin tip pajisje eshte percaktuar ne menyre te arsyeshme dhe standarte ne menyre te atill qe siguron funksionimin e pandërprer te pajisjeve, minimizon ndërprerje per furnizim te ri me leter dhe rrit effiçencen e procesit te printimit ,Specifikimi teknik i kapaciteteve te letres nuk eshte kufizues sepse i lejon operatorët ekonomik te ofertojnë me pajisje te cilat kane edhe nje kapacitet me te larte letrë.

Kapse Dokumentash (stapler) automatik

Stapler automatik siguron perpunim te shpejt dhe efikas te dokumentave te printuara , duke minimizuar ndërhyrjen manuale nga stafi dhe duke rritur produktivitetin ne procesin administrativ. Gjithashtu garanton qe dokumentet e printuara/fotokopjuara te jene lehtesisht te organizuara per shperndarje apo arkivim.Ky specifikim teknik eshte i nevojshem per te reduktuar kohen e perpunimit te dokumentave.

- Software për menaxhimin dhe monitorimin e pasjeve te printimit dhe shërbimit.

Menaxhimi dhe kontrolli i realizimit te shërbimit në sasi e cilësi do të bëhet me pajisje Software. Për software të menaxhimit të pajisjeve të printimit, operatori duhet të ketë akses vetem në shikimin e numrit të faqeve të printuara dhe fotokopjuara, ndërkohë që do të jetë Seksioni IT, që do të bëjë menaxhimin e dokumentave të fotokopjuara dhe skanuara.

Specifikimet teknike minimale të Programit Softuerit:

1	Monitorimin i statusit të pajisjeve në kohe reale.
2	Menaxhimin dhe konfigurimin e pajisjeve në mënyrë të centralizuar. Krijimi i profileve të ndryshme të printimit, skanimit me anet e software dhe shpërndarjen e konfigurimit te të gjithë pajisjet, një grup apo disa pajisje në mënyrë automatike.
3	Raportim me e-mail për sasinë e printimeve të secilit user (nëse aplikohet), të gjithë pajisjeve apo një grupi të tyre.

4	Menaxhimin e pajisjeve me usera (<i>nëse kërkohet</i>) dhe konfigurimet përkatëse në mënyrë të centralizuar.
5	Ruajtja e raporteve në server në mënyrë periodike (ditore, javore, mujore, vjetore).
6	Dërgimi i e-mail automatike në rast të shfaqjes së problemeve teknike.
7	Dërgimi i e-mail automatike që tregon statusin e tonerit dhe lajmërimi për ndërrimin e tij në mënyrë proactive.
8	Krijimi i raporteve për sasinë e printimeve, fotokopjimeve, skanimeve për secilin user, departament, drejtori...etj.
9	Software duhet të ruaje në database të gjithë aktivitetin e pajisjes dhe të mundësojë krijimin e raporteve mbi baze pajisjesh apo grupi pajisjesh. Krijimin e raporteve për kohën që pajisjet kanë qëndruar pa punë për arsye të problemeve teknike, krijimin e raporteve për kohën e shfaqjes dhe zgjidhjes së një problemi teknik dhe shpjegimin e natyrës së problemit të shfaqur.
10	Instalimi i një serveri që të bëjë të mundur monitorimin e të gjithë printerave në rrjet, për të sinjalizuar me anë të e-mail për probleme të ndryshme si difekte, mbarimin e bojës dhe nxerrje të numerit të printimeve etj.
11	Mundësimi për upgrade automatic me anë të software të versioneve të fundit të firmareve të pajisjeve.
12	Pull dhe secure printing të implementohet në pajisjet që kërkohet.
13	I gjithë sistemi duhet të jetë automatik dhe të monitorohet nga një qendër e vetme.

Specifikimet teknike të letrës A4, A3 (Brand i njohur Nderkombetar).

1.	Letër fotokopje A4, Risma 500 flete
2.	Letër fotokopje A3, Risma 500 flete
Letra A4	
-Përmasa A4 (297mm x 210 mm);	
-Lëmueshmëria: 80-130 ml/min; sipas ISO 8791	
Lagështia: 3.5-4.5% sipas ISO 287-Trashësia: 103-115 µm sipas ISO 534;	
-Shkëlqimi: 101-115% sipas ISO 2470-2;	
- Dukshmëria >94% sipas ISO 2471;	
- CIE bardhësia: 148-170 sipas ISO 11475;	
-Të plotësojë standardet që letra të mbahet për kohë të gjatë në arkivë sipas ISO-s 9706 ,80 gr/m2.	
Letra A3	
-Përmasa A3 (420mm x 297mm);	

-Lëmueshmëria 100-150ml/min sipas ISO 8791;
- Lagështia 3-4% sipas ISO 287;
- Trashësia 109-115 µm sipas ISO 534;
- Dukshmëria (Opacity) >94% sipas ISO 2471;
- Shkëlqimi 106-115% sipas ISO 2470-2;
- CIE Bardhësia 158-175 sipas ISO 11475.

Ambalazhimi: Mbështjellje kundër lagështirës dhe kuti me kapacitet 5 risma, letra të mos bllokojë makinën fotokopjuese apo printerin, fax-in, të qëndrojnë e rrafshët pas printimit apo fotokopjimit, të mos lëshojë pluhur letre pas printimit apo fotokopjimit, të jetë e përshtatshme për printim në të dyja anët, të plotësojë standardet që letra të mbahet për kohë të gjatë në arkiv, sipas ISO 9706, të mos jetë e ricikluar.

Gramatura: Siguron që letra të mos jetë as shumë e hollë (rrezik ngjitjeje dhe dëmtimi), as shumë e trashë (rrezik për bllokim në pajisje

Trashësia: Ndhmon në qëndrueshmëri dimensionale dhe përpunim të saktë mekanik në pajisje me ushqim automatik.

Lëmueshmëria: Siguron sipërfaqe të përshtatshme për transferim të pastër të bojës/tonerit. dhe parandalon defektet në cilësinë e printimit.

Lagështia: Parandalon fryrje, valëzim ose thyerje të letres. Siguron që letra të ruajë formën dhe cilësinë gjatë printimit dhe arkivimit

Dukshmëria: Garanton që printimi në një faqe të mos duket në faqen tjetër, gjë që është thelbësore për printim në të dy anët (duplex printing).

Shkëlqimi: Jep një kontrast të lartë vizual mes bojës dhe letres, duke përmirësuar lexueshmërinë dhe prezantimin profesional të dokumenteve.

Bardhësia: Tregon nivel të lartë bardhësie optike, për pamje të pastër dhe prezantim cilësor. Ndikon pozitivisht në perceptimin e cilësisë së dokumenteve zyrtare.

Lidhur me specifikimet e letres jemi bazuar ne Katalogun e OBP „Blerje materiale Kancelarie“ përditësuar datë 23.10.2025.

AK për të siguruar që letra e propozuar përputhet me specifikimet teknike të kërkuara nga Autoriteti Kontraktor (AK) dhe për të shmangur rrezikun e dështimit të implementimit të kontratës për shkak të përdorimit të materialeve të papërshtatshme.

Dorëzimi i modeleve dhe skedave teknike shërben për të:

1. Siguruar që pajisjet e printimit të propozuara përputhen me specifikimet teknike të kërkuara,
2. Krijuar një panoramë të qartë për Autoritetin Kontraktor mbi pajtueshmërinë e produkteve të ofruara,

3. Shmangur rrezikun e dështimit të implementimit të kontratës në rast se pajisjet që do të dorëzohen gjatë zbatimit nuk përputhen me specifikimet teknike të kërkuara.

Specifikimet teknike, termat e referencës dhe përlogaritja e fondit limit janë përgatitur dhe hartuar nga Autoriteti Kontraktor Përfitues (Drejtoria Vendore e Policisë Durrës), për nevojat e së cilit, Operatori i Blerjeve të Përqëndruara, në cilësinë e Organit Qendror Blerës kryen procedurën e prokurimit, në zbatim të Ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, VKM-në nr.531 datë 7.9.2023 “Për krijimin e shoqërisë aksionare shtetërore “Operatori i Blerjeve të Përqëndruara” Sh.a për kryerjen e procedurave të veçanta të prokurimit publik, në emër dhe për llogari të Kryeministrit, Ministrive dhe Institucioneve të Varësise”, i ndryshuar.

Specifikimet teknike janë hartuar nga specialist I fushes për objektin që prokurohet, i ngritur me Urdhër të Titullarit për hartimin e specifikimeve teknike, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 41, pika 1, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.

Specifikimet teknike janë hartuar duke marrë në konsideratë nevojat e Autoritetit Kontraktor, për shërbimet objekt procedure prokurimi, duke përlogaritur sasitë e nevojshme, karakteristikat e duhura dhe standardet e duhura kombëtare dhe ndërkombëtare, sipas parashikimeve të nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar si dhe nenit 41, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar duke u bazuar në përvojën dhe eksperiencën e viteve të kaluara që ka rezultuar e sukseshme. Specifikimet teknike, për shërbimin objekt prokurimi, përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 42, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.